



| | | |
|---|---|--|
|  | <p>Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština -Municipality of Prishtina</p> | <p>PRISHTINA</p>  |
|---|---|--|

| | |
|--------------------------------|--|
| Datë/a: | 07.06.2016 |
| Referenc-ë: | 01-561 |
| Për/ Za/ To: | Kryetarin e Komunës, z. Shpend Ahmeti Drejtorin e Administratës, z. Muhedin Nushi |
| Përmes/Preko/Through: | Qendra për shërbim me qytetarë |
| Nga/ Od/ From: | Zyra komunale për komunitete dhe kthim |
| Tema/ Subjekat/Subject: | Raport për muajin maj 2016 |

Raport mujor

1. Hyrje¹

Qëllimi i këtij raporti është që të ofrohet përshkrimi i standardizuar i punës dhe fushëveprimit të Zyrës për muajin maj 2016. Raporti i muajit maj përfshinë aktivitetet e zhvilluara dhe takimet e punës së Zyrës. Komuna dhe të gjitha mekanizmat përkatës janë angazhuar për ofrimin e mbështetjes dhe udhëzimeve konkrete për komunitetet joshumicë.

Si çështje kryesore gjatë këtij muaji kanë qenë: riintegrimi i personave të riatdhesuar; miratimi i Planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës; vizita në terren në Slivovë; procedimi i lëndëve për ndihmë në MKK; takimet koordinuese dhe konsultuese me organizatat ndërkombëtare etj.

2. Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve

Qasja e komuniteteve në shërbimet komunale gjatë këtij muaji ka qenë e kënaqshme, duke udhëzuar palët në çështjet konkrete të kompetencave që kanë drejtoritë komunale. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të komuniteteve në Komitetin për Komunitete paraqet mekanizmin ndërlidhës për çështjet e

¹ Ky shabllon raportimi është hartuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve të Zyrës së Kryeministrit për të gjitha Zyrat Komunale për Komunitete. Tre pjesët e para janë me përshkrimet kryesore. Pjesa e katërt me aktivitetet mujore.

komuniteteve joshumicë.

Zyra procedon çdo kërkesë që ndërlidhet me kthimin e të zhvendosurve në pronën përkatëse të komuniteteve joshumicë. Zyra i udhëzon në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, e cila ka fondin përkatës për të zhvendosurit, në rast të plotësimit të të gjitha kriterëve procedurale dhe ligjore.

Riintegrimi i personave të riatdhesuar përbën një çështje tjetër, ndaj së cilës ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për plotësimin e kriterëve të caktuara për riintegrim. Shqyrtimi i kërkesave për riintegrim bëhet nga Komisioni komunal për riintegrim, i cili mblidhet varësisht prej numrit të kërkesave apo rasteve emergjente.

Është mbajtur mbledhja e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, ku ndër pikat e rendit të ditës ishte miratimi i Planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës. U njoftuan se ky Plan-veprim ka një rëndësi të veçantë në procesin e integrimeve evropiane, aq më shumë se me këtë Planveprim parashihet zbatimi i të gjitha rekomandimeve të institucioneve të përfshira në procesin e riintegrimin.

Rregullorja (QRK) nr. 04/2016, për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimin, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi, më 22 mars 2016. Me këtë rregullore është paraparë gjenerimi i të ardhurave përmes financimit të planbizneseve, e që Komisioni qendror për riintegrim nga MPB-ja merr vendim për secilin rast. Për rastet në gjendje të rëndë sociale, veçmas Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Qendra për Punë Sociale, do të jenë bartëset kryesore të këtij procesi.

3. Këshillat e dhëna për ekzekutivin komunal dhe autoritetet përfaqësuese

Zyra ka njoftuar organet komunale për përgjegjësitë dhe obligimet që dalin nga Rregullorja (QRK) e miratuar nr. 04/2016, për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimin. Me këtë rregullore është paraparë gjenerimi i të ardhurave përmes financimit të planbizneseve, e që Komisioni qendror për riintegrim nga MPB-ja merr vendim për secilin rast. Është obligim i Komunës në menaxhimin e këtyre rasteve që plotësojnë kriteret për përfitime emergjente. Obligimet dhe përgjegjësitë që parashihen në këtë rregullore për komunat, rrjedhin nga Ligji për vetëqeverisje lokale dhe Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit.

4. Aktivitetet

Më 03.05.2016, Zyra ka mbajtur takime javore me stafin e Zyrës, duke renditur aktivitetet javore për çdo javë. Në këto takime diskutohet edhe për propozimet që ka stafi lidhur me çështje të ndryshme të diversitetit kulturor dhe etnik, por edhe me koordinimin e mekanizmave të tjerë në këtë proces.

Më 04.05.2016, z. Mustafë Neziri zhvilloi vizitë në terren me koordinatorin rajonal të MPB-së z. Sokol Rexhëbogaj. Është vizituar i riintegruari z. Behram Hyseni, për të evidentuar kushtet e banimit dhe kërkesën eventuale lidhur me pakot e riintegrimin.

Më 05.05.2016, z. Lulzim Vrapca mori pjesë në takimin e grupit për të drejta sociale, ku u diskutuan projektet e organizatave joqeveritare lidhur me grupet e marginalizuara. Kërkesa përcjellëse, detajet dhe kostoja buxhetore e projekteve të paraqitura do të vlerësohen në një takim tjetër nga anëtarët e grupit për të drejta sociale dhe partneri implementues GIZ.

Më 05.05.2016, vendimet për ndihmë të familjeve të z. Slobodan Bojkoviç dhe znj. Mazade Balkan, janë nënshkruar dhe proceduar për zbatim në Drejtorinë e Financave. Vendimet janë nënshkruar nga Kryetari i Komunës për ndihmë familjeve të përmendura. Familjes së z. Bojkoviç i janë shkaktuar dëme nga reshjet e mëdha të shiut, derisa familjes së znj. Balkan i është djegur shtëpia dhe jeton me qira me katër anëtarë, tre prej të cilëve janë paaftë fizikisht dhe psikikisht.

Më 06.05.2016, z. Mustafë Neziri dhe z. Lulzim Vrapca nga ZKKK, zhvilluan takim pune me z. Nenad Miladonoviç. Qëllimi kryesor i takimit ishte se deri në cilën fazë kanë arritur projektet e procedura për investime kapitale. U konstatua që në takimin e radhës së Komitetit për Komunitete, të ftohet shefi i Prokurimit dhe të japë shpjegimet e nevojshme për projektet e investimeve kapitale.

Më 10.05.2016, z. Lulzim Vrapca dhe z. Mustafë Neziri zhvilluan takim pune me koordinatorin rajonal të MPB-së z. Sokol Rexhëbogaj. Temë diskutimi për herë të dytë brenda këtij viti ishte formular-pyetësori i dërguar nga MPB-ja për të riatdhësuarit që janë kthyer nga fillimi i këtij viti.

Më 11.05.2016, znj. Slavica Stoliç dhe z. Nenad Miladinoviç zhvilluan takim pune në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Qëllimi i takimit ishte dorëzimi i lëndëve për ndihmë të kërkesave të komuniteteve joshumicë dhe shqyrtimi i lëndëve për ndërtim të kërkesave të dorëzuara prej disa vitesh.

Më 11.05.2016, z. Mustafë Neziri zhvilloi vizitë në terren tek familja e znj. Suzana Salihu, për verifikimin e rastit, nëse e përmendura ende jeton me qira në banesën e ndarë nga MPB-ja. U konstatua se znj. Suzana Salihu banon në banesën e ndarë nga MPB-ja.

Më 12.05.2016, z. Lulzim Vrapca zhvilloi takim pune me shefin e koordinatorëve rajonalë të MPB-së z. Kushtrim Nreci. Është diskutuar lidhur me procesin e riintegrit të personave të riatdhesuar dhe masat e riintegrit të qëndrueshëm, që janë duke u zbatuar gjatë kësaj faze.

Më 13.05.2016, Komisioni i Komitetit për Komunitete, në krye me z. Sylejman Pireva, ka vizituar shkollat ku vijojnë mësimin nxënës të komuniteteve: rom, ashkali, egjiptas, turk dhe boshnjak. Më gjerësisht keni raportin e hartuar nga kryetari i komisionit dhe të shqyrtuar në takimin e kaluar.

Më 13.05.2016, z. Lulzim Vrapca zhvilloi takim pune me z. Agim Radoniqi nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor. Qëllimi i takimit ishte lëshimi i dokumentit original për të riintegruarin z. Elmi Selmani, i cili vërteton se MMPH është donator për ndërtimin e shtëpisë së z. Elmi Selmani. Mbetet që ditëve në vijim të zbatohet kërkesa e përmendur.

Më 16.05.2016, z. Lulzim Vrapca zhvilloi takim pune me z. Vebi Mujku nga Qendra për Punë Sociale. Qëllimi i takimit ishte procedimi i rasteve të riintegruara në QPS, problemet dhe sfidat e procesit të riintegrit. U konstatua se është e nevojshme që ministritë e linjës dhe mekanizmat e përfshirë në këtë proces të zbatojnë legjislacionin në fuqi.

Më 17.05.2016, z. Mustafë Neziri zhvilloi vizitë në terren për verifikimin e rastit të të riintegruarit z. Elmi Selmani, nëse i përmenduri vazhdon të banojë në banesën e ndarë nga MPB-ja. U konstatua se z. Elmi Selmani është në banesën e ndarë nga MPB-ja, deri në zgjidhjen e çështjes së banimit.

Më 17.05.2016, z. Lulzim Vrapca mori pjesë në seminarin e organizuar nga OSBE-ja, ku qëllimi kryesor ishte diskutimi i dispozitave kryesore në lidhje

me përgjegjësitë e zyrtarëve komunalë lidhur me hapat që duhet ndërmarrë gjatë procesit të informimit të të drejtave pronësore.

Më 18.05.2016, në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet projektit të GIZ-së, SoRi, "Të drejtat sociale për grupet e cënueshme dhe strukturave përkatëse në nivel komunal", Grupi për të drejtat sociale ka marr pjesë në trajnimin e radhës "Pako e re ligjore për të drejtat e njeriut", e cila përfshin ligjet përkatëse, i cili trajnim është mbajtur në Durrës, nga data 18-20 maj. Në këtë trajnim ka marrë pjesë edhe z. Lulzim Vrapca. Nga ky trajnim u konstatua se pako ligjore për të drejtat e njeriut dhe grupet e cënueshme përbën një rëndësi të madhe ndër fushat kryesore, ku koordinimi institucional duhet të jetë në nivel me qëllim të zbatimit të plotë të akteve ligjore në fuqi.

Më 18.05.2016, është mbajtur takim i Komitetit për Komunitete. U shqyrtuan pikat e rendit të ditës, raporti i Zyrës për Komunitete, dhe u shpjeguan procedurat teknike administrative të riprocedimit të projekteve të investimeve kapitale të vitit 2015. U propozua që përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë të sjellin listën me emra të familjeve të cënueshme të komuniteteve joshumicë.

Më 19.05.2016, znj. Slavica Stoliç ka zhvilluar vizitë në Slivovë dhe është takuar me përfaqësuesin e komunitetit serb z. Sreçko Stojanoviç. Qëllimi i vizitës ishte procedimi i projektit të ujit dhe implementimi i tij. U konstatua se ky projekt ka filluar së implementuari dhe është në fazën përfundimtare. Vetëm kushtet atmosferike kanë ndikuar që ky projekt të jetë ende i papërfunduar.

Më 20.05.2016, z. Mustafë Neziri zhvilloi takim pune me z. Selim Hyseni nga MPB-ja. Qëllimi i takimit ishte "Sistemi për menaxhimin e rasteve të të riatdhesuarve për riintegrim. Gjithsesi, inkuadrimi i të dhënave në SMR paraqet vetëm një rëndësi të madhe ndër pikat kryesore të këtij procesi dhe në SMR do të inkuadrohen vetëm të riintegruarit që plotësojnë kriteret.

Më 23.05.2016, z. Lulzim Vrapca zhvilloi takim pune me arkitektin e Drejtorisë së Urbanizmit z. Zejnullah Rexhepi. Qëllimi i takimit ishte kushtet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizmit për të riintegruarin z. Elmi Selmani, duke ditur se ndërtimi i shtëpisë së tij është neglizhuar me muaj të tërë për shkak të procedurave dhe moslëshimit të pëlqimit ndërtimor. Z. Zejnulla Rexhepi theksoi se dokumentet e përcaktuara në shkresë duhet të sillen vetëm origjinal ose në kopje të noterizuara dhe më pas do të shqyrtojmë lëndën.

Më 24.05.2016, në takimin e Komitetit për Komunitete është marr konkluzion që përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë, të sjellin listën me emra të familjeve të cënueshme të komuniteteve joshumicë. Këtë evidentim të listës e kanë sjellë përfaqësuesi i komunitetit serb, përfaqësuesi i komunitetit rom dhe përfaqësuesi i komunitetit turk.

Më 25.05.2016, znj. Klaudia Mula zhvilloi takim pune me drejtoreshën e Kulturës, znj. Saranda Bogujevci, për të diskutuar rreth përkrahjes së anëtarit të komunitetit ashkali z. Jakup Berisha. Nga organizata ndërkombëtare "IOM" është përzgjedhur si përfitues i projektit të mjeteve të punës që ka kërkuar për artin me penj, por me kusht që 10% e shumës së kërkuar të jetë nga përfituesi. I përmenduri është nxënës dhe nuk ka mundësi të bashkëfinancojë mjetet e kërkuara. Kërkohet nga Drejtoria e Kulturës që shumën prej 10% ta financojë në projektin e përmendur të vlerës totale, që i bie 400 Euro. Drejtoresha sugjeroi që të dorëzohet kërkesa me shkrim, pastaj Komisioni do ta shqyrtojë kërkesën në fjalë.

Më 26.05.2016, znj. Klaudia Mula ka takuar anëtarin e komunitetit ashkali z. Fetah Krasniqi. I përmenduri ka parashtruar kërkesë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike për shfrytëzimin e hapësirës publike *për promovimin e artit të tij të veçantë të pikturave të transformuara në dru* dhe ka marr përgjigje negative. Është lajmëruar në Zyrë dhe ZKKK ka kontaktuar me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, e cila është përgjigjur se kërkesa në fjalë është refuzuar, pasi mund të pengojë qytetarët kur organizohen aktivitete të ndryshme në shesh. ZKKK ka kërkuar që kërkesa e tij të rishqyrtohet dhe të shikohet mundësia që anëtarit të komunitetit ashkali t'i jepet në shfrytëzim hapësira prej 2 m² në ndonjë pjesë në sheshet e qytetit. Qëllimi kryesor është promovimi i artit të tij të veçantë të pikturave të transformuara në dru, me të cilin talent mban edhe familjen.

Më 27.05.2016, ZKKK ka njoftuar OJQ-të vendore që merren me çështje të komuniteteve joshumicë, se mund të marrin pjesë në aktivitetet e tyre për nder të 1 Qershorit - Ditës së Fëmijëve "Prishtina lexon", të organizuar nga Komuna e Prishtinës.

Më 27.05.2016, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prishtinës është miratuar Plani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës. Po ashtu, u propozua edhe emërimi i anëtarit të Komitetit për Komunitete nga radhët e komunitetit boshnjak.

Më 30.05.2016, z. Lulzim Vrapca zhvilloi takim pune me z. Agim Radoniqi nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, për të dytën herë brenda muajit, me qëllim të lëshimit të dokumentit për të riintegruarin z. Elmi Selmani për ndërtimin e shtëpisë, dokument që vërteton se Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është donatore për shtëpinë.

Më 31.05.2016, me kërkesë të anëtarit të Komitetit për Komunitete z. Hetem Kupina, janë listuar projektet e investimeve kapitale për komunitetet joshumicë gjatë viteve: 2014, 2015 dhe 2016, si vijon:

❖ Projektet e investimeve kapitale për vitin 2014, të realizuara:

1. Ndriçimi i rrugës në Bërnice të Poshtme,
2. Ndriçimi në kishën "Sveti Nikola" në Prishtinë,
3. Rrethimi dhe pastrimi fito-sanitar i varrezave në Bërnice të Poshtme,
4. Rrethimi i varrezave-oborrit të kishës në Bërnice të Epërme - faza e parë,
5. Rrethimi i varrezave multietnike në Kolovicë dhe
6. Vendosja e dy kontejnerëve-shtëpizë në kishën e Bardhoshit dhe ndriçimin e saj.

❖ Projektet e investimeve kapitale për vitin 2015:

1. Vazhdimi i rrethimit të varrezave të Kishës në Bërnice të Epërme,
2. Pastrimi dhe rrethimi i varrezave serbe në Bardhosh,
3. Pastrimi dhe rrethimi i varrezave në Kolovicë - faza II, e përfunduar,
4. Pastrimi dhe rrethimi i varrezave ashkalike në Bërnice të Epërme,
5. Vazhdimi për ndriçimin publik në Bërnice të Poshtme,
6. Rrethimi dhe pastrimi i varrezave ashkalike në Besi,
7. Rrethimi dhe pastrimi i varrezave serbe në Hajvali,
8. Furnizimi me ujë të pijshëm në Slivovë - e kontraktuar.

❖ Projektet e investimeve kapitale për vitin 2016:

1. Pastrimi dhe rrethimi i varrezave myslimane në Bardhosh,
2. Pastrimi dhe rrethimi i varrezave serbe në Matičan,
3. Ndërtimi i rrethojës së Kishës në Bërnice të Poshtme me themel betoni,

4. Ndriçimi i shtatë rrugicave në Bardhosh dhe ndriçimi i rrugës në Bërnice të Epërme prej Shkollës deri tek kroi i Milevcit,
5. Vendosja e zebrave dhe shportave të mbeturinave në lagjen “Kodra e Trimave”.

Çështje të tjera teknike-administrative të Zyrës, parashtrimi i shkresave, përgjigje disa palëve lidhur me procesin e riintegrit, procesin e ankimimit dhe të drejtave që u takojnë. Procedimi i projekteve për rishpallje, kërkesave interne për procedim të mëtejshëm dhe në afat sa më të shpejtë kohor.

Zyra për Komunitete dhe Kthim